



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 34
Prishtinë, më 9 Tetor 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225
Mbledhja filloi në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë: Rustem Mustafa, Gani Geci, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Selmanaj dhe Zylfi Merxha.

Munguan: Agim Veliu, Melihate Termkolli, Bojan Stojanovič, Shkumbin Demaliaj, dhe Emrush Xhemajli.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj, Fatbardha Boletini, Nuredin Ibishi dhe Blerina Pula.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbaleve të datës **27.07.2009** dhe **02.09.2009**
3. Shqyrtimi i raportit nga Ministria e Punëve të Brendshme
4. Shqyrtimi i projekt-Strategjisë kundër korrupsionit 2009-2011
5. Të ndryshme

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të datës 27.07.2009 dhe 02.09.2009

Procesverbalet e datës 27.07.2009 dhe 02.09.2009 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit nga Ministria e Punëve të Brendshme

Kryetari i Komisionit – tha, në mbledhjen e kaluar kemi diskutuar për situatën aktuale të sigurisë dhe për të pasur informata më të sakta, kemi kërkuar raporte nga MPB-ja, EULEX-i dhe Presidenca. Në lidhje me këtë, MPB-ja ka sjellë një raport, ndërsa EULEX-i ka sjellë një njoftim.

Gani Geci – Në raportin e sjellë nga MPB-ja, komandantët e Policisë në regjionin e Mitrovicës i raportojnë EULEX-it, dhe në raport përshkruhet se e njoftojnë Policinë e Kosovës. Duhet të merren masat ndaj personave që nuk i raportojnë zinxhirit komandues të Policisë së Kosovës.

Ibrahim Selmanaj – Nga një informatë jo zyrtare kam kuptuar se disa kilometra brenda territorit tonë, në kufiri me Malin e Zi, janë vendosur tabela me mbishkrim mirë se vini në Malin e Zi. Kjo është shkelje e kushtetutës dhe mendoj se komisioni duhet të shkoj të vizitohet këtë pjesë të Kosovës dhe të dal me propozimet e veta se çka të ndërmerret.

Eqrem Kryeziu - Mendoj se duhet të procedojmë me këtë pyetje dhe të kuptojmë se çka po ndodh afër kufirit, dhe të ndërmerren hapat konkret në lidhje me këtë çështje.

Kryetari i Komisionit – tha, kushtetuta nuk po shkelet por vetëm jemi duke bërë përpjekje se si të vihet në funksion.

4. Shqyrtimi i Projekt-strategjisë kundër korrupsionit 2009-2011

Kryetari i Komisionit – tha, unë propozoj që ti rekomandojmë Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e Projekt strategjisë kundër korrupsionit 2009-2010.

Gani Geci – Problem kryesor në zbatimin e ligjit kundër korrupsionit është lidhja farefisnore e krimit të organizuar dhe lidhja me mafia. Ne kemi probleme me gjykatat dhe zbatimin e ligjit. Unë mendoj se ligji i prokurimit duhet të jetë më efikas.

Eqrem Kryeziu – Unë mendoj se është shumë i domosdoshëm miratimi i Projekt strategjisë. Edhe pse kjo projekt strategji nuk është si duhet mirëpo ne duhet ti kemi të paktën disa praktika se si duhet të veprohet më tutje.

Zylfi Merxha – Për të gjitha këto ngjarje që kanë ndodhur duhet të ndërmerren hapat konkret. Duhet të vizitohen të gjitha ato vende ku ndodhin këto ngjarje në territorin e Kosovës, dhe të veprohet në atë drejtim.

Ibrahim Selmanaj – Unë mendoj se është mjaft e rëndësishme të hapet debati për këtë projekt strategji dhe mbi bazën e zhvillimit të diskutimit që do të bëhet, do të del një përfundim.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që Projekt strategjia të shqyrtohet dhe miratohet në seancë.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – tha, ju njoftoj se së bashku me stafin kemi filluar që të hartojmë Planin për Mbikëqyrjen Pro-aktive të Sektorit të Sigurisë.

Zafir Berisha – Unë dua të përmendi çështjen e Policisë së Kosovës, që janë kategoria më e nënçmuar. Mendoj se duhet të bëhet diçka në rritjen e pagave, pasi që në trajnimin e Policëve të Kosovës është investuar shumë. Duhet të mendohet në krijimin e kushteve në Policinë e Kosovës, e pastaj të kërkohet edhe përgjegjësia prej tyre.

Gani Geci – Unë mendoj se ligji për Policinë nuk është duke u zbatuar. Ne duhet të kërkojmë prej Ministrin të Punëve të Brendshme, që në buxhetin e vitit 2010 të parashihet zbatimi i ligjit për Policinë.

Pasi që nuk kishte pika tjera për të diskutuar, kryetari i komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatiti:
Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit
Rrustem Mustafa